

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE 2022

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1	02/03/2022	<p>Informacion në lidhje me subjektet që kërkojnë të jenë importues të produkteve ushqimore nga BE (Itali). Produkte duke filluar nga makarona oriz por edhe ato blegtoralë dhe te ngrira (peshk), kane nevojë për leje nga AKU?</p>	07/03/2022	<p>Ju informojmë, si më poshtë vijon: - Çdo subjekt që kryen veprimtari me natyrë ekonomike jo vetjake në fushën e ushqimit "prodhim dhe/ose tregtim të ushqimeve", duhet te regjistrohet dhe licencohet sipas legjislacionit në fuqi. - Procedura e regjistrimit dhe licencimit kryhet në përputhje me: Ligjin Nr.9863, date 28.01.2008 “Për Ushqimin” i ndryshuar (neni 19), Ligjit Nr. 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, Ligjit nr.10081, date 23.2.2009 “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimit me Nr.538, datë 26.5.2009 “ Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKB dhe disa rregullave të tjera nënligjore të përbashkëta” e ndryshuar si dhe akte te tjera ligjore/nënligjore ne fuqi. Përshkrimi i veprimtarive të cilat kanë detyrim ligjor licencimin: Veprimtaria e “Prodhimit dhe/ose Tregtimit të ushqimeve”, është kategoria II.1 e Shtojcës së Ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”. Nën Kategoria (Kodi: II.I.A): Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve, me veprimtari specifike: Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz (II.I.A.1). Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për kafshë që përdoren për ushqim (II.I.A.2). Nën Kategoria (Kod II.I.B): Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz).</p>	E plotë	Nuk ka

			<p>- Subjekti importon jo vetëm produkte me natyre Jo shtazorë (makarona oriz) dhe produkte ushqimore me natyre shtazore (blegtoralë dhe te ngrira (peshk)</p> <p>Për sa më sipër cituar:</p> <p>- Veprimtaria e Subjektit i përket kodit të veprimtarisë (Kodi II.I.B): “Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)”, pra vetëm për produktet ushqimore me origjinë shtazore (në rastet kur subjekti kryen vetëm aktivitet tregtues për këto produkte).</p> <p>- Nuk kanë detyrim ligjor të pajiset me licencë nëse subjekti kryen vetëm aktivitet tregtues të produkteve ushqimore me natyre Jo-shtazore (pasi nuk parashikohet në legjislacionin përkatës), por pavarësisht saj është objekt inspektimi nga ana e AKU-së.</p> <p>Referuar VKM-së Nr. 538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKB dhe disa rregullave të tjera nënligjore të përbashkëta” e ndryshuar, për licencat e grupit të tretë (që i përkasin AKU-së); Fusha II, USHQIMI DHE SHËNDETI, Kategoria II.I, PRODHIMI DHE/OSE TREGTIMI I USHQIMEVE, pika 19 e saj citon: Subjektet që kryejnë veprimtari me pakicë lidhur me nënkategoritë A dhe B e që kupton subjektet e regjistruara si pagues të taksës vendore mbi biznesin e vogël nuk licencohen. Këto subjekte janë të detyruara të njoftojnë autoritetet e përmendura si institucion tjetër lidhur me nënkategoritë A dhe B për vendin e kryerjes së aktivitetit dhe natyrën e tij jo më vonë se 30 ditë nga fillimi i veprimtarisë me pakicë”.</p> <ul style="list-style-type: none"> · Aplikimi për pajisje me licencë bëhet pranë Institucionit të QKB-së në sportelet e saj, apo në portalin e-Albania. · Aktet që duhet ti bashkëngjiten një kërkesë aplikimi janë të shfaqura në faqen zyrtare të QKB-së dhe AKU-së. · Para aplikimit duhet të plotësohen kriteret përkatëse të licencimit. <p>AKU ushtron kontrollin në vend për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe kriterëve, sipas legjislacionit në fuqi. Është detyrë e çdo Operatori të Biznesit Ushqimor që përgatit, përpunon, prodhon, ruan dhe shpërndan, produkte ushqimore në mjedise të ushtrimit të aktivitetit me pakicë apo shumicë, të sigurojë zbatimin me rigorozitet të kërkesave dhe kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të higjienës, rregullat dhe standardet e</p>		
--	--	--	--	--	--

				<p>detyrueshme tekniko teknologjike, ne ambientet e tij, si dhe dokumentacion te rregullt te produkteve ushqimore sipas legjislacionit perkatës.</p> <p>Procedura e shqyrtimit dhe vendimmarrjes qe nga momenti i shfaqjes ne sistemin aplikativ të QKB-së në kompetencë të AKU-së zgjat 15 ditë (afati kohor).</p> <p>Për sa shpjeguar më sipër mbetemi në kontakt për çdo paqartësi apo informacion shtesë.</p> <p>Aktet ligjore dhe nënligjore perkatëse mund ti gjeni dhe në faqen zyrtare të AKU-së.</p>		
2	7.3.2022	<p>Për shkëmbimet tregtare nga ana e një kompanie italiane, ju lutem na informoni në lidhje me certifikatat sanitare/fitosanitare /veterinare të kërkuara nga autoritetet shqiptare në lidhje me produktet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - sallamra dhe djath - konservat e perimeve - makarona - makarona të freskëta - makarona të mbushura - oriz - kremra ushqimore vegjetale - miell -domate të konservuara; <p>Na specifikoni nëse raporti i analizave mund të kryhet apo jo nga një laborator i brendshëm i vetë kompanisë italiane? Në rast të kundërt, në çfarë laborator i duhen kryer? Ekziston një listë e laboratorëve</p>	11.3.2022	<p>Në lidhje me importet e produkteve te mëposhtme informojmë se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Për produktet “sallamra” kërkohet që të jenë të shoqëruara me certifikatë shëndetësore veterinare për produktet e mishit, të lëshuar nga autoriteti kompetent i vendit eksportues në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe rregulloreve të BE-së. - Për produktin “djathë” kërkohet që të jenë të shoqëruara me certifikatë shëndetësore veterinare për qumësht dhe produktet e qumështit, të lëshuar nga autoriteti kompetent i vendit eksportues në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe rregulloreve të BE-së - Për “konservat e perimeve”, “makarona”, “ makarona të freskëta”, “ makarona të mbushura”, “ kremra ushqimore vegjetale”, “ domate të konservuara” bazuar ne Udhërin 374, datë 31.8.2017, Për një ndryshim në urdhrin Nr.72, datë 15.3.2011 , “Për Miratimin e Akt – Kontrollit “Mbi Inspektimin e produkteve ushqimore me origjinë Jo Shtazore në pikat e inspektimit kufitar dhe lejimin për kryerjen e veprimeve të mëtejshme për zhdoganimin e tyre ” dhe Akt “Marrje Mostre” produktet me origjinë jo shtazore te cilat importohen ne RSH duhet te shoqërohen me dokumentacionin perkatës: <ul style="list-style-type: none"> - Certificate Origjine - Raport Analize - Fature 		

		të aprovuar nga shteti shqiptar? Ekziston një model i raportit të analizave të aprovuar nga të dyja shtetet? Ju lutemi gjithashtu të na specifikoni karakteristikat që duhet të ketë raporti i analizave, si dhe gjuhën në të cilën duhet lëshuar (italisht, anglisht apo shqip).		- Për produktet “oriz”, dhe “miell” bazuar në “Urdhrin 374, datë 31.8.2017 Për një ndryshim në urdhrin Nr.72, Datë 15.03.2011 , “Për Miratimin e Akt Kontrollit “Mbi Inspektimin e produkteve ushqimore me origjinë jo shtazore në pikat e inspektimit kufitar dhe lejimin për kryerjen e veprimeve të mëtejshme për zhdoganimin e tyre ” dhe Akt “Marrje Mostre” produktet me origjinë jo shtazore te cilat importohen ne RSH si dhe Ligjit Nr. 105/2016 datë 27.10.2016 ”Për Mbrojtjen e Bimëve”, ngarkesat të cilat importohen ne RSH duhet te shoqërohen me dokumentacionin përkatës: - Certificate Origjine - Fature - Raport Analize - Certificate Fitosanitare		
3	09/03/2022	Kërkojmë të na vini në dispozicion informacion në lidhje me këto pyetje: 1.Sa qumësht është importuar nga Serbia dhe vendet e tjera në vitet 2019, 2020 dhe 2021? (Ju lutem specifikoni me të dhëna konkrete) 2.Sa qumësht pluhur është importuar nga Serbia dhe vendet e tjera në vitet 2019, 2020 dhe 2021? (Ju lutem specifikoni)	18.3.2022	Ju informojmë si vijon në lidhje me importin e produktit qumësht përgjatë viteve 2019-2020-2021: -Gjatë vitit 2019 janë importuar në total 11699.33 ton qumësht, nga të cilat 4613.845 ton janë importuar nga Serbia. Vendet e tjera nga të cilat është importuar produkti qumësht janë: Austri, Belgjikë, Bosnje Hercegovinë, Gjermani, Greqi, Holandë, Hungari, Itali, Kinë, Kosovë, Kroaci, Maqedoni, Poloni, Rumani dhe Slloveni. -Gjatë vitit 2020 janë importuar në total 10123.43 ton qumësht, nga të cilat 1465.575 ton janë importuar nga Serbia. Vendet e tjera nga të cilat është importuar produkti qumësht janë: Angli, Belgjikë, Bosnje Hercegovinë, Gjermani, Greqi, Holandë, Hungari, Itali, Kosovë, Kroaci, Maqedoni, Poloni, Slloveni dhe Spanjë. -Gjatë vitit 2021 janë importuar në total 13810.85 ton qumësht, nga të cilat 5813.065 ton janë importuar nga Serbia. Vendet e tjera nga të cilat është importuar produkti qumësht janë: Angli, Austri, Belgjikë, Bosnje Hercegovinë, Gjermani, Greqi, Holandë, Hungari, Itali, Kosovë, Kroaci, Maqedoni, Poloni, Rumani, Slloveni dhe Spanjë. Ju informojmë si vijon në lidhje me importin e produktit qumësht pluhur përgjatë viteve 2019-2020-2021:	E plotë	Nuk ka

			<p>-Gjatë vitit 2019 janë importuar në total 1128.514 ton qumësht pluhur, nga të cilat 2.76 ton janë importuar nga Serbia. Vendet e tjera nga të cilat është importuar produkti qumësht pluhur janë: Austri, Bullgari, Çeki, Danimarkë, Gjermani, Greqi, Irlandë, Belgjikë, Rumani, Holande, Itali, Lituani, Maqedoni, Poloni dhe Ukrainë.</p> <p>-Gjatë vitit 2020 janë importuar në total 1010.004 ton qumësht pluhur, ku evidentohet se nuk ka patur import nga Serbia për këtë produkt. Vendet nga të cilat është importuar produkti qumësht pluhur janë: Angli, Belgjikë, Bullgari, Çeki, Irlandë, Norvegji, Greqi, Holandë, Itali, Kroaci, Lituani, Maqedoni, Poloni dhe Ukrainë.</p> <p>- Gjatë vitit 2021 janë importuar në total 1614.7392 ton qumësht pluhur, ku evidentohet se nuk ka patur import nga Serbia për këtë produkt. Vendet nga të cilat është importuar produkti qumësht pluhur janë: Angli, Belgjikë, Bullgari, Çeki, Francë, Irlandë, Greqi, Gjermani, Holandë, Itali, Lituani, Maqedoni, Poloni, Turqi dhe Ukrainë.</p>		
--	--	--	---	--	--

4	16/03/2022	<p>Një subjekt që importon produkte ushqimore, nga vendet e BE-së, fletë-analizat e lëshuar nga furnitorët e huaj, vendet e BE-së, për produkte të caktuara, a konsiderohen të vlefshme (nëse përkthehen në gjuhën shqipe)? AKU apo subjekti duhet të ribëjë analiza përsëri në laboratorët e licencuara në Shqipëri?</p>	25.3.2022	<p>Referuar legjislacionit me të cilin operon AKU për procedurat e importit të produkteve ushqimore me origjinë jo shtazorë të cilat në momentin e hyrjes duhet të shoqërohen me raport analize e cila është e përkthyer në gjuhën shqipe, kjo raport analize është e vlefshme edhe për tregtimin e produkteve në Shqipëri, prandaj nuk është e nevojshme që produktet të nënshtrohen analizimit nga e para.</p>	E plotë	Nuk ka
---	------------	---	-----------	--	----------------	---------------

5	16/03/2022	<p>Kërkojmë informacion në lidhje me këto pyetje:</p> <p>1.A ka pasur ngordhje masive të pulave?</p> <p>2.Nëse po, cila ka qenë arsyeja?</p> <p>3.Sa pula raportohet se kanë ngordhur dhe në cilën periudhë kohore? (Ju lutem specifikoni)</p> <p>4. Çfarë masash janë marrë nga ana juaj?</p>	25.3.2022	<p>Autoriteti Kombëtar i Ushqimit nuk është institucioni kompetent në lidhje me përgjigjet e pyetjeve Tuaja. Autoriteti përgjegjës për këtë informacion është Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural si autoriteti kompetent për shëndetin e kafshëve të gjalla, referuar legjislacionit në fuqi (Ligji Nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore. Kërkesa u përcoll pranë Koordinatorit për të drejtën e informimit në Ministrinë e Bujqësisë.</p>	E plotë	Nuk ka
---	------------	--	-----------	--	---------	--------

6	21.3.2022	<p>Lidhur me shqetësimin që disa lexues të revistës kanë shfaqur në lidhje me rastet e gripit të shpendëve të evidentuara së fundmi në qytetin e Durrësit. Në kuadër të detyrës tonë për informimin publik, do dëshironim të dinim nga institucioni që ju përfaqësoni se sa të rrezikuar janë qytetaret nga kjo ngjarje? A duhet ndaluar aktualisht konsumimi i mishit të pulës dhe nënprodukteve si vezët?</p>	21.3.2022	<p>AKU siguron konsumatorët se ushqimet me origjinë shpërdorë në treg janë brenda standardeve të gjurmueshmerise dhe janë të verifikuara nga inspektorët tanë, të cilët janë duke ri vërejtur në terren çdo subjekt tregtues, përpunues mishi shpendësh për një perkoresi të plote të gjurmues mërisë. Ftojme konsumatorët të mos bien për e abuzuesve dhe spekulanteve që tregtojnë mish shpendësh pa certifikatë veterinare ose në kushte të papërshtatshme tregtie a magazinimi.</p> <p>Sigurojmë se gjithë veterineret tanë, janë në gatishmëri për të vërejtur me përgjegjësi dhe nëpërmjet kontrolleve zyrtare, gjithë problematiken si pjese e detyrës tone, por edhe nga zhvillimet e fundit.</p> <p>Sugjerojmë që ushqimet e mishit të shpendëve të llojit pule duhet të gatuhet në temperatura mbi 70 °C dhe vezët po ashtu të jene të gatuar mire. Gatimi i plote i mishit dhe vezëve siguron pamundësinë e virusit për prani në produkte të papërpunuara që hyjnë në zinxhirin ushqimor. Virusi është i ndjeshëm ndaj nxehtësisë dhe dezinfektuesve po ashtu, prandaj praktikat e mira higjienike (dezinfektimi i sipërfaqeve) dhe higjiena personale (larja e duarve) ndihmon në kontrollin e rrezikut.</p> <p>Nuk ka prova epidemiologjike se ky virus mund të transmetohet tek njerëzit mes ushqimit (shpendëve e vezëve).</p>	E plotë	Nuk ka
---	-----------	---	-----------	---	---------	--------

7	16.3.2022	<p>Një subjekt që importon produkte ushqimore, nga vendet e BE-së</p> <p>Në vijim të sa me sipër dhe pas studimit të legjislacionit, na rezulton se nuk është e qartë, nëse flete-analizat e lëshuara nga furnitorët e huaj, (vendet e BE-se), për produkte të caktuara, a konsiderohen të vlefshme (nëse përkthehen në gjuhën shqipe), nga AKU apo subjekti duhet të ribëje analiza përsëri në laboratorët e licencuar në Shqipëri?</p> <p>Në pritje të përgjigjes tuaj, për te vijuar me tej.</p>	25.3.2022	<p>Referuar legjislacionit me të cilin operon AKU për procedurat e importit të produkteve ushqimore me origjinë jo shtazorë të cilat në momentin e hyrjes duhet të shoqërohen me raport analize e cila është e përkthyer në gjuhën shqipe, kjo raport analize është e vlefshme edhe për tregtimin e produkteve në Shqipëri, ndaj nuk është e nevojshme që produktet të nënshtrohen analizimit nga e para.</p>	E plotë	Nuk ka
8	19.4.2022	<p>1- A keni kryer kontrole nëse janë hequr nga tregu të gjitha llojet e kinder të ndaluar?</p> <p>2- Nëse po, sa është numri I tyre?</p> <p>3-Cfarë ndodh me bizneset që ende kanë në shitje këto produkte?</p>	20.4.2022	<p>AKU menjëherë pas marrjes së njoftimit nga sistemi RASFF si dhe nga vete kompania mori masat për kryerjen e kontroleve zyrtare në kuadër të verifikimit të rastit në subjektet importuese, si dhe në subjektet ku këto produkte tregtohen, bazuar në gjurmueshmërinë e shpërndarjes së këtyre produkteve për sa i përket importit dhe me pas shpërndarjes në vend.</p> <p>Nga verifikimet e kryera, u identifikuan lotet përkatëse dhe produktet lidhur me to. Nga inspektorët e DRAKU-ve u morën masa për bllokimin e këtyre lotëve të produkteve (duke evidentuar emrin e produktit, datën e prodhimit dhe datën e skadencës, formatin dhe mënyrën e paketimit, si dhe vendin e origjinës) në përputhje me të dhënat e marra zyrtarisht nga njoftimet përkatëse. Gjithashtu, u bë tërheqja nga tregu e të gjithë produkteve referuar loteve problematike të produkteve, të cilat janë grumbulluar dhe janë të bllokuara nga AKU. Gjithashtu po merren masat për kryerjen e procedurave të asgjësimit të tyre konform legjislacionit në fuqi.</p>	E plotë	Nuk ka

9	20.4.2022	<p>Pyetje 1: Sa vaj palme është importuar në vendin tonë në vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021?</p> <p>Pyetje 2: Sa qumësht pluhur është importuar në vend në vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021?</p> <p>Pyetje 3: Nga janari 2019 deri në prill 2022, a ka marrë AKU mostra rastësore sallami në kompaninë X, Y dhe Z për t'i kryer analizat? (Nëse po ju lutem na informoni në lidhje me numrin e analizat e kryera për periudhën e sipër cituar njëkohësisht edhe me rezultatet e tyre.)</p>	29.4.2022	<p>Në subjektet ku produktet i ishin tregtuar konsumatorit të fundit u bë afishimi i njoftimit për kthimin e produkteve (për lotet përkatës të njoftimeve) dhe mos konsumimin nga konsumatorët.</p> <p>Përgjigja nr. 9</p>	E plotë	Nuk ka
---	-----------	---	-----------	--	---------	--------

10	28.4.2022	<p>Kërkojmë informacion për procedurën e aplikimit për Akt miratimi Higjeno – Sanitar. Më përpara është marrë te ISHSH. Me ndryshimet e ligjit 54/2020 datë 30/04/2020 ISHSH nuk na pajis me Certifikim por na drejton te AKU për tu pajisur me këtë Certifikim.</p> <p>Ju lutem mund të na udhëzoni për procedurën e aplikimit?</p>	26.5.2022	<p>Në lidhje me kërkesën, për pajisje me Akt Miratimi Higjeno Sanitar, subjekti nuk ka nevojë të aplikojë për një të tillë, por I mjafton inspektimi I fundit nga AKU rajonale (aty ku subjekti ushtron aktivitetin), ku subjekti operon konform ligjit dhe sipas rregullave e normave ne fuqi. Ndërsa për mjetet e transportit, lëshohet Akt Miratimi Higjeno Sanitar, duke aplikuar ne AKU rajonale (aty ku subjekti ushtron aktivitetin).</p>	E plotë	Nuk ka
11	3.5.2022	<p>A janë hequr kufizimet për vaksinim të detyrueshëm për punësimin e punonjësve të rinj në supermarkete ?</p>	4.5.2022	Deleguar	E plotë	Nuk ka
12	8.5.2022	<p>Ku mund të drejtohem për të marre informacion për dokumentacionin që më nevojitet për subjektin bar, mini restorant? Ku ndodhen zyrat qëndrore të AKU?</p>	9.5.2022	<p>Referuar kërkesës tuaj për informacion rreth dokumentacionit që duhet të dispononi për ushtrimin e aktivitetit duhet të referoheni në faqen zyrtare te AKU ose në Drejtorinë Rajonale, Qarku Tiranë me adresë : Rruga "Hamdi Pepa", Selitë, Tiranë.</p> <p>Ju mund të paraqiteni fizikisht për te marre informacionin e nevojshëm.</p>	E plotë	Nuk ka

13	9.5.2022	<p>Kërkojmë nga ju të na vini në dispozicion informacion në lidhje me këto pyetje:</p> <p>1.A janë kryer kontrolle nga AKU për tregtimin e qumështit në rrugë? 2.Ku janë shtrirë këto kontrolle, në cilat qytete? 3. Çfarë është evidentuar nga këto kontrolle?</p>	18.5.2022	<p>Lidhur me inspektimet e kryera nga AKU për tregtimin e produktit "qumësht në rrugë" ju informojmë se:</p> <p>Subjektet apo personat fizikë që tregtojnë në rrugë, produktet e qumështit, nuk janë objekt kontrolli i AKU.</p> <p>Nga ana tjetër, AKU kryen kontrolle në zbatim të kërkesave të legjislacionit në fuqi për sigurinë ushqimore në "subjekte/persona fizik ose juridik, të regjistruar për të kryer veprimtari, që lidhen me biznesin ushqimor, përgjegjës për të siguruar se kërkesat e ligjit të ushqimit janë arritur në biznesin ushqimor të kontrolluar prej tij".</p> <p>AKU nuk ushtron kontrolle për tregtimin e qumështit në rrugë, por pavarësisht kësaj ju bëjmë me dije se gjatë kryerjes së kontrolleve zyrtare (inspektime në zbatim të planit vjetor) nuk është konstatuar tregtimi i këtij produkti në tregje apo dhe në vende të cilat nuk janë të lejuara për tregtimin e tij dhe gjatë kësaj periudhe DRAKU-të nuk kanë konstatuar tregtimin e qumështit nga individë ose persona të pa autorizuar në rrugë apo nëpër trotuare.</p> <p>Ky shqetësim i ngritur nga ana juaj do vazhdoje të jetë në fokusin e AKU dhe në rast të konstatimit të tregimit të këtij produkti do të njoftohen menjëherë strukturat përkatëse.</p>	E plote	Nuk ka
----	----------	---	-----------	---	---------	--------

14	16.5.2022	Lidhur me importin e produktit krem për lehtësimin e dhimbjeve muskulare dhe artritit. Në këto raste si veprohet? Ky lloj produkti duhet të regjistrohet diku?	17.5.2022	Deleguar	E plotë	Nuk ka
15	23.5.2022	<p>Për arsye studimore kërkoj marrjen e përgjigjes se pyetjes si me poshtë?</p> <p>Bazuar në mbikëqyrjen e sigurisë ushqimore në Shqipëri për vitin 2021, cilat rezultojnë produktet që përbejnë rrezik ose nuk kanë përmbushur standardet e duhura ne treg?</p> <p>Nga analizimi, kontrollimi dhe monitorimi i produkteve shtazore (në vend dhe të importuara) cilat janë rezultatet për përdorimin e sasisë së hormoneve dhe sigurisë së tyre ndaj konsumatorit?</p>	26.5.2022	Përgjigja nr. 15	E plotë	Nuk ka

16	27.5.2022	Si mund te aplikoj pranë AKU-se Fier për punësim. Kam kryer studimet për kimi dhe teknologji ushqimore gjithashtu dhe studimet master shkencor.	2.6.2022	<p>Ju informojmë se kërkesa për punësim duhet të dërgohet nëpërmjet adresës zyrtare të emailit të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (info@aku.gov.al) dhe/ose në rrugë zyrtare pranë pranë Zyrës së Protokollit në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU-së.</p> <p>Kjo kërkesë duhet të përmbajë të dhënat për arsimimin, eksperiencën e punësimit, etj. dhe bashkëlidhur kësaj kërkesë të vendosen një fotokopje të kartës së identitetit, një CV dhe diploma/ve që Ju dispononi.</p>	E plotë	Nuk ka
17	18.6.2022	<p>Në kuadër të një dokumentari që po realizojmë për Bujqësinë dhe mbështetjen e dhënë ndaj këtij sektori kemi nevojë për disa informacione nga ana e institucionit juaj:</p> <p>1- Cilat janë produktet ushqimore dhe shtazore që Shqipëria eksporton?</p> <p>2- Sa në korrespondencë me Autoritetin Kombëtar të Ushqimit janë politikat subvencionuese të skemave mbështetëse të Bujqësisë?</p> <p>3- A garantojnë cilësinë dhe sigurinë ushqimore ata që subvencionohen?</p>	24.6.2022	<p>Përgjigja nr. 17</p>	E plotë	Nuk ka

18	31.7.2022	Disponoj një biznes familjar për tregti mishi në qytetin e Vlorës. Pata marrë një gjobe nga AKU-ja. Pas disa zarfesh të dërguara, zarfi i fundit i dërguar nga AKU-ja e Tiranës, më ka humbur. Në këtë zarf jepen vendimi përfundimtar i gjobës ku me këtë dokument duhet ta ankimoje ne gjykatë. Ku mund ta gjej këtë dokument përsëri? A mund te ma dërgoni ju?	9.8.2022	Kërkesa juaj u përcoll pranë Drejtorisë Rajonale Vlore, e cila do t'ju vendose ne dispozicion dokumentacionin e kërkuar. Ju mund te pajiseni me një kopje te njehsuar pranë Drejtorisë Rajonale Vlore.	E plotë	Nuk ka
19	12.8.2022	A mund të më ndihmoni për një format Excel për gjurmueshmërinë e produkteve (hyrjet dhe daljet e tij sipas datës së skadencës) edhe për një regjistër pastrimi ose te më jepni ndonjë informacion mbi to.	25.8.2022	Në përgjigje të kërkesës tuaj, ju informojmë si më poshtë vijon: Referuar nenit 3, pika 15 të Ligjin Nr. 9863 datë 28.1.2008 "Për Ushqimin" (i ndryshuar) citohet se "Gjurmim/ gjurmueshmëri është aftësia për të gjurmuar dhe ndjekur një ushqim, ushqim për kafshë, kafshët që prodhojnë ushqim, ose substanca të përcaktuara, që janë ose priten të jenë të lidhura me një ushqim për njerëz ose kafshë, në të gjitha fazat e prodhimit, të përpunimit dhe të shpërndarjes". Operatori i biznesit ushqimor dhe ushqimit për kafshe duhet te krijojë një sistem te efektshëm të gjurmueshmërisë, në mënyrë të tillë që çdo tërheqje e nevojshme e produktit te kryhet saktësisht dhe specifikisht, si dhe të jepen informacionet	E plotë	Nuk ka

20	29.8.2022	<p>Jam një punonjëse në një biznes privat bar- kafe, dhe kam aplikuar për Akt Miratimi Higjeno Sanitarë pranë e-Albania-s, dhe më vjen përgjigje që duhet të aplikojë pranë jush .</p> <p>Ju lutem mund të më drejtoni nëse duhet të vijë pranë zyrave tuaja për aplikim apo online</p>	30.8.2022	<p>e nevojshme për konsumatorët dhe autoritetet kompetente sikurse parashikohet edhe në VKM Nr. 760, datë 16.9.2015 "Për Kërkesat për Gjurmimin e Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshe Përgjatë Zinxhirit Ushqimor". Është detyre e çdo biznesi i cili ushtron aktivitetin e tij ne fushën e ushqimit të disponojë në çdo kohë informacionin e nevojshëm justifikues për gjurmueshmërinë.</p> <p>Për sa me lart, çdo OBU është i lirë të zgjedhe një mënyrë të cilën e mendon ai të përshtatshme dhe efikase për të mbajtur dhe disponuar në çdo moment këtë informacion. Gjithashtu edhe mënyra e mbajtjes se këtij informacioni nuk është e përcaktuar pasi ajo mund te jetë në mënyrë digjitale ose analoge (hard copy).</p> <p>Referuar kërkesës tuaj lidhur me aplikimin për Akt Miratimi Higjeno-Sanitar Ju informojmë si më poshtë vijon: Në zbatim të Ligjit Nr. 54/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 7643, datë 2.12.1992 ‘Për Inspektimin Sanitar të Ndryshuar’, sqarojmë se plotësimi i kushteve dhe kërkesave ligjore higjiene sanitare ndaj Operatorëve të Biznesit Ushqimor i është atribuuar tërësisht si kompetencë Autoritetit Kombëtar të Ushqimit. Si pasojë e ndryshimeve të sipërcituara, theksojmë se verifikimi i zbatimit të kërkesave ligjore referuar kushteve higjiene-sanitare ezaurohet tashmë nga kontrollet inspektuese të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit. Kërkesat</p>	E plotë	Nuk ka
----	-----------	---	-----------	--	---------	--------

21	25.8.2022	<p>dhe dokumentet që duhet të paraqes.</p> <p>Po shkruaj në emër të Ambasadës Polake në Tiranë lidhur me barrierat me vendet e Bashkësisë Evropiane për importin e produkteve ushqimore nga një vend të BE në Shqipëri.</p> <p>Ne e dimë se ka certifikata shëndetësore, sipas informacionit që kemi parë në faqen zyrtare (https://aku.gov.al/modelet-e-certifikatave/#1559817639454-db4a18df-bcaf), por nëse ka ndonjë informacion shtesë për tregun polak, ju lutemi na informoni.</p> <p>Nuk ka gjithashtu pengesa për ëmbëlsirat apo alkoolin?</p>	31.8.2022	<p>ligjore në fuqi të cilat verifikohen në kuadër të procesit inspektues nga DRAKU-te janë ato të parashikuara në Ligjin Nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për Ushqimin” i ndryshuar, si dhe Udhëzimin Nr. 22, datë 25.11.2010 “Për kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të higjienës për stabilimentet e ushqimit dhe operatorët e biznesit ushqimor”[1] etj.</p> <p>Shënim: [1] Aktet e mësipërme i gjeni në faqen zyrtare të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit: www.aku.gov.al</p> <p>Në përgjigje të emalit tuaj, përmes të cilit kërkohet informacion për importin e produkteve ushqimore, ju sqarojmë se; Importi i produkteve ushqimore bazohet në;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ligji Nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për Ushqimin” i ndryshuar. • VKM Nr. 434, datë 11.07.2018 për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit. • Urdhri 374, datë 31.08.2017 Për një ndryshim në urdhrin Nr.72, datë 15.03.2011, “Për Miratimin e Aktit – Kontrollit “Për inspektimin e produkteve ushqimore me origjinë jo shtazore në pikat e inspektimit kufitar dhe lejen për të kryejnë veprimet e mëtejshme për zhdoganimin e tyre” dhe Aktin “Marrja e mostrave”, produktet ushqimore të importuara në RSH duhet të shoqërohen me dokumentacionin përkatës: <p>Si dhe akte të tjera ligjore.</p> <p>Referuar legjisllacionit të sipërpërmendur, dokumentacioni i kërkuar për importin e produkteve me origjinë jo shtazore është si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Certifikata e origjinës • Raporti i analizës • Certifikata Fito-Sanitare sipas rastit <p>Dokumentacioni i nevojshëm për importin e produkteve me origjinë shtazore është si më poshtë:</p>	E plotë	Nuk ka
----	-----------	---	-----------	--	---------	--------

			<ul style="list-style-type: none"> • Njoftimi paraprak i subjektit përpara mbërritjes së ngarkesës. • Pjesa e parë e DVIT. • Certifikatë Shëndetësore Veterinare, në përputhje me legjislacionin në fuqi. • Produkti i cili importohet/eksportohet duhet të jetë nga një ndërmarrje e autorizuar për eksport. • Fatura e mallrave. • Lista e produkteve kur dërgesa ka më shumë se një produkt. <p>Gjithashtu sqarohet se nuk kërkohet informacion shtesë për tregun polak. Në lidhje me barrierat për importin e produkteve nga BE për ëmbëlsirat dhe alkoolin ju informojmë se nuk ka barrierë për të kryer import të këtyre produkteve në Republikën e Shqipërisë.</p> <p>Bazuar në legjislacionin me të cilin operon Autoriteti Kombëtar i Ushqimit , për të kryer import të këtyre produkteve është detyrim ligjor që ngarkesa të shoqërohet me dokumentacionin përkatës të mbështetur në Urdhrin 374, datë 31.08.2017 Për një ndryshim në Urdhrin Nr.72, datë 15.03.2011 , “Për Miratimin e Akt – Kontrollit “Mbi Inspektimin e produkteve ushqimore me origjinë Jo Shtazore në pikat e inspektimit kufitar dhe lejinin për kryerjen e veprimeve të mëtejshme për zhdoganimin e tyre ” dhe Akt-“Marrje Mostre” i cili është:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Certificate Origjine • Raport Analize • Fature <p>Dokumente keto te cilat vërtetojnë sigurinë e produkteve ushqimore.</p>		
--	--	--	--	--	--

22	29.8.2022	<p>Unë do të doja të kërkoja ndihmën tuaj në çështjen e mëposhtme.</p> <p>Një kompani hungareze do të zhvillojë një event në Shqipëri. Ata do të donin të shërbenin ushqim hungarez në këtë ngjarje. Nuk e dimë ende nëse përbërësit do të transportohen në Shqipëri dhe ushqimi do të përgatitet këtu, apo ushqimi do të transportohet i gatshëm . Çfarë lejesh do të nevojiten? Unë supozoj se kjo varet nga fakti nëse ata po sjellin lëndë të parë apo ushqim të gatshëm në Shqipëri. Cila është procedura më e qëndrueshme?</p>	31.8.2022	<p>Në përgjigje të emailit tuaj, përmes të cilit kërkohet informacion për importin e produkteve ushqimore me rastin e një event, ju sqarojmë se; Importi i produkteve ushqimore bazohet në; Ligji Nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për Ushqimin” i ndryshuar. Vendim KM Nr. 434, datë 11.07.2018 për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit. Urdhri 374, datë 31.08.2017 Për një ndryshim në urdhrin Nr.72, datë 15.03.2011, “Për Miratimin e Aktit – Kontrollit “Për inspektimin e produkteve ushqimore me origjinë jo shtazore në pikat e inspektimit kufitar dhe lejen për të kryejnë veprimet e mëtejshme për zhdoganimin e tyre” dhe Aktin “Marrja e mostrave”, produktet ushqimore të importuara në RSH duhet të shoqërohen me dokumentacionin përkatës: Si dhe akte të tjera ligjore.</p> <p>Referuar legjislacionit të sipërpërmendur, dokumentacioni i kërkuar për importin e produkteve me origjinë jo shtazore është si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Certifikata e origjinës • Raporti i analizës • Certifikata Fito-Sanitare sipas rastit <p>Dokumentacioni i nevojshëm për importin e produkteve me origjinë shtazore është si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Njoftimi paraprak i subjektit përpara mbërritjes së ngarkesës. • Pjesa e parë e DVIT. • Certifikatë Shëndetësore Veterinare, në përputhje me legjislacionin në fuqi. • Produkti i cili importohet/eksportohet duhet të jetë nga një ndërmarrje e autorizuar për eksport. • Fatura e mallrave. • Lista e produkteve kur dërgesa ka më shumë se një produkt. 	E plotë	Nuk ka
----	-----------	--	-----------	--	---------	--------

23	19.9.2022	Doja të informohesha te ju nëse ka vende të lira pune pjese e AKU-se. Kam mbaruar studimet për kimi industriale dhe mjedisore.	22.9.2022	<p>Pasi u njohëm me email tuaj drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit dhe duke Ju falenderuar për interesimin e paraqitur nga ana juaj për t'u punësuar pranë Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Ju informojmë se aktualisht Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, nuk ka asnjë pozicion vakant në përputhje me fushën tuaj të edukimit.</p> <p>Gjithashtu, ju bëjmë me dije se kërkesa juaj për punësim pranë Autoritetit Kombëtar të Ushqimit është regjistruar dhe do të njoftoheni në një moment të dytë kur të krijohet një vend vakant.</p>	E plotë	Nuk ka
23	22.9.2022	Jam e interesuar për pune tek zyrat e AKU ne qytetin e Shkodrës.	22.9.2022	<p>Pasi u njohëm me kërkesën tuaj dhe duke Ju falenderuar për interesimin e paraqitur nga ana juaj për t'u punësuar pranë Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Ju informojmë se aktualisht pranë Drejtorisë Rajonale të AKU-së, Qarku Shkodër, nuk ka asnjë pozicion vakant në përputhje me fushën tuaj të edukimit.</p> <p>Gjithashtu, ju bëjmë me dije se kërkesa juaj për punësim pranë Autoritetit Kombëtar të Ushqimit është regjistruar dhe do të njoftoheni në një moment të dytë kur të krijohet një vend vakant.</p>	E plotë	Nuk ka
24	21.9.2022	Ju lutem ku mund ti gjejmë te publikuara seritë e salsiçeve Woody te kontaminuara?	22.9.2022	<p>Përgjigja nr. 24</p>	E plotë	Nuk ka

25	10.10.2022	Doja të pyesja a është e mundur të bëhet praktika në AKU për inspektor nëse kam mbaruar detyrimet e bachelorit dhe kam dy provime te mbartura në degën bioteknologji.	10.10.2022	Pasi u njohëm me emailin tuaj drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit dhe duke ju falënderuar për interesimin e paraqitur nga ana juaj për të për të zhvilluar praktikën pranë Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Ju informojmë se dokumentet që duhen për të zhvilluar praktikën janë si më poshtë: 1. Kërkesë drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit për zhvillimin e praktikës. 2. Fotokopje kartë ID. 3. Vërtetim nga Universiteti që jeni student.	E plotë	Nuk ka
26	5.10.2022	Jam i interesuar të informohem në lidhje me detyrimet e një Kompanie te huaj që planifikon të eksportojë produkte ushqimore në Shqipëri Përveç përmbajtjes në gjuhën shqipe a është e detyrueshme të vendoset edhe emri i distributorit? Nëse është e detyrueshme, në kushtet që planifikon të ketë më shumë se 1 distributor a është e lejueshme të mos e stampojë këtë informacion?	12.10.2022	Në përgjigje të kërkesës tuaj, ju informojmë përkatësisht si më poshtë: Ushqimi i importuar në Republikën e Shqipërisë nxirret në treg kur plotëson kërkesat e Ligjit Nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për Ushqimin” i ndryshuar, dhe të legjislacionit në fuqi. Kërkesat për importin e produkteve me origjinë shtazore: <ul style="list-style-type: none"> • Njoftimi paraprak i subjektit para mbërritjes së ngarkesës. • Pjesa e parë e DVIT. • Certifikata shëndetësore veterinarë, në përputhje me legjislacionin në fuqi. • Të gjitha subjektet importuese duhet të jenë të pajisura me licencën përkatëse. • Produkti i cili importohet/eksportohet duhet të jetë nga një stabiliment i autorizuar për kryerjen e eksportit. • Fatura e mallit. • Lista e produkteve kur ngarkesa ka më shumë se një produkt. Kërkesat për importin e produkteve me origjinë jo shtazore: <ul style="list-style-type: none"> • Certificate Origjine • Raport Analize • Fature Zbatohen kërkesat e Ligjit Nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për Ushqimin” i ndryshuar, Urdhër 374, datë 31.08.2017, Mbi inspektimin e produkteve ushqimore me Origjine Jo shtazore në pikat e inspektimit kufitar dhe lejimin për kryerjen e veprimeve te mëtejshme për zhdoganimin e tyre dhe AKT-Marrje Mostre	E plotë	Nuk ka

27	18.10.2022	Do t'ju lutesha të më informoni me kushtet që duhet të plotësojë një kompani që të importojë dhe tregojë mishin.	20.10.2022	<p>VKM-së Nr.434, datë 11.7.2018 “Për Etiketimin e ushqimeve dhe informimin konsumatorit”, Neni 15, pika 2, Kërkesat për gjuhën shqipe. Për produktet ushqimore të importuara, deklarimi i të dhënave të informacionit ushqimor duhet të jepet në gjuhën shqipe, në etiketën origjinale ose në kundër etikete.</p> <p>Subjekti importues/distributor për Shqipërinë, në etiketën e produktit të cilin nxjerr në treg në vendin tonë duhet të ketë edhe emrin e subjektit prodhues të vendit të origjinës së produktit si dhe emrin e tij si importues për Republikën e Shqipërisë. Këto të dhëna si dhe të dhëna të tjera të nevojshme referuar VKM-së Nr.434, datë 11.7.2018 “Për Etiketimin e ushqimeve dhe informimin konsumatorit” duhet të jene në gjuhën shqipe. Gjithashtu në lidhje me rastin në fjale mund të drejtoheni edhe pranë zyrave të drejtorisë rajonale të AKU në qarkun ku subjekti importues ushtron aktivitet për të marre të gjithë informacionin e nevojshëm.</p> <p>Përgjigja nr. 27</p>	E plotë	Nuk ka
28	11.11.2022	Si duhet të jenë fletë-analizat e produkteve ushqimore të importuara, pasi legjislacioni ynë nuk përmend përkthimin në gjuhën shqipe?	14.12.2022	<p>Në lidhje me përkthimin në gjuhën shqipe të fletë-analizave ju informojmë se produktet ushqimore të cilat importohen në Republikën e Shqipërisë duhet të jenë të shoqëruara me fletë-analize në gjuhën shqipe si dhe në gjuhën e vendit prej nga ato vijnë, bazuar në Ligjin Nr. 9863, datë 28.1.2008, "Për Ushqimin" (i ndryshuar), Neni 18 , pika 4.</p>	E plotë	Nuk ka

29	15.11.2022	Ju lutemi të na informoni mbi vlerat të konsideruara brënda normës, në lidhje me analizat kimike që shoqërojnë mallin në import në Shqipëri. Kompania në fjalë është prodhuese e pijes alkoolike GIN.	9.12.2022	Referuar kërkesës në lidhje me normat e lejuara për pijet alkoolike, në këtë rast Gin, aktualisht me STASH me të cilat ne punojmë, produkti Gin nuk bën pjesë pasi është produkt i ri në treg, dhe normat referohen si mëposhtë: -STASH 1551/1-87 'Pije alkoolike Përcaktimi i alkoolit etilik' - (Sipas deklaramit në etiketë) -STASH 1551/2-87 'Pije alkoolike Përcaktimi i aciditetit të përgjithshëm - (Nuk ka normë) -STASH 1551/3-87 'Pije alkoolike Përcaktimi i estereve- (Nuk ka normë) -STASH 1551/4-87 'Pije alkoolike Përcaktimi i aldehideve- (Nuk ka normë) -STASH 1551/5-87 'Pije alkoolike Përcaktimi i furfuroolitit- (Nuk ka normë) -STASH 1551/6-87 'Pije alkoolike Përcaktimi i alkooleve të larta- (Nuk ka normë) -STASH 1551/7-87 'Pije alkoolike Përcaktimi i alkoolit metilik- (Nuk ka normë) -STASH 1551/8-87 'Pije alkoolike Përcaktimi i ekstraktit të përgjithshëm- (Nuk ka normë).	E plotë	Nuk ka
30	5.12.2022	Ju lutem do të doja një informacion, mbi llojet dhe kategoritë e qumështit që një shoqëri tregtare me objekt veprimtarie "përpunim dhe shitje të nënprodukteve të qumështit" mund të importojë. P.sh : A mund të importojmë qumësht bruto i cili nuk ka kaluar asnjë proces fizik përpunimi,qumësht të pasterizuar në cisternë apo qumësht të kondensuar? A mund t'i importojmë këto nga	14.12.2022	Përgjigja nr. 30	E plotë	Nuk ka

31	14.12.2022	<p>çdo shtet i huaj apo vetëm nga vendet e BE?</p> <p>Referuar Urdherit nr.329 i vitit 2021,"Një ndryshim mbi Urdherin nr.438 e vitit 2008: Rregullore mbi "Kushtet e shëndetit publik dhe të shëndetit të kafshëve të certifikatave të qumështit si lëndë e parë dhe të produkteve me bazë qumështi për konsum human", ne mund të importojmë qumësht nga Shtetet Anetare të Bashkimit European.</p> <p>Duke qenë se lidhur me vendet e BE, ky urdhër nuk bën specifikime të kategorive të qumështit që mund të importohet, a mund të nënkuptojmë se ketu lejohen të gjitha kategoritë? Pra qumësht i papërpunuar,qumësht i përpunuar në procese të ndryshme etj ?</p>	22.12.2022	<p>Ushqimi i importuar në Republikën e Shqipërisë nxirret në treg kur plotëson kërkesat e Ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 "Për Ushqimin" i ndyshuar, dhe legjislacionit në fuqi.</p> <p>Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian, janë vende nga te cilat lejohet importi në Republikën e Shqipërisë të dërgesave të qumështit të papërpunuar, produkteve të qumështit, kolostrum dhe produkteve me bazë kolostrumi dhe duke treguar llojin e trajtimit me nxehtësi të kërkuar për këto produkte.</p> <p>Ngarkesa e ushqimit të importuar shoqërohet me certifikatë, në përputhje me kërkesat ndërkombetare, për sigurinë e ushqimit që importohet, në përputhje me kërkesat e Nenit 18, Certifikatat e importit, të Ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 "Për Ushqimin" i ndyshuar.</p>	E plotë	Nuk ka
----	------------	--	------------	--	---------	--------

--	--	--	--	--	--	--

